 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA ZA OSOBLJE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.133/18	Data: 01.08.2018	

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, Komuna e Istogut ,shpall:

K O N K U R S

Për kryerjen e punëve me kontratë për kohë të caktuar

Vendi i punës: Roje Pylli

Institucioni : Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

Numri i Ekzekutuesve: 1 (një)

Numri i referencës:

Paga mujore: 300 € në muaj

Kohëzgjatja e Emrimit : Me afat të caktuar – 1 (një) vit

Orari i plotë : 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Bënë ruajtjen nga vjedhja, shkatërrimi, dëmtimi, trungjet e pa prera dhe të prera si dhe pjesëve të trungjeve – drunjëve në pyje, kulturat pyjore, pyllëzime, tokat pyjore dhe prodhimet pyjore jodrunore ;
2. Bënë parandalimin e gjuetisë ilegale, përkujdeset mbi mbrojtjen e kafshëve të egra si dhe mbrojtjen e objekteve në terenet e gjuetisë;
3. Bënë kryerjen e procedurave të qarkullimit të masës drunore dhe kontrollimin e transportit të prodhimeve drunore dhe jodrunore të pyjeve ;
4. Bënë zbatimin e planit të masave të përcaktuara në mbrojtjen preventive të pyjeve nga zjarret, mirëmbajtjen e pikave vrojtuese , vendosjen e shenjave parandaluese dhe ndalesave;
5. Bënë ndalimin e kullotjes ilegale, dëmtimet nga kullotje, nxjerrjen e gurëve, zhavorit, dheut dhe deponimeve të mbeturinave në pyjepa lejen e organit përgjegjës;
6. Bënë paraqitje për veprimet ilegale të prerjes, nxjerrjes, grumbullimit, përpunimit të materialit drunor dhe jo drunor dhe të njëjtat të dërgojë në Gjykatat Kompetente;
7. Bënë kontrollimin e shfrytëzimit të pyjeve në ngastrat e lejuara për shfrytëzim në pyjet publike dhe merr masa ndaj shfrytëzimeve jashtë lejes apo veprimeve tjera ilegale;
8. Si dhe punë të tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

Kushtet për punësim :

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Përparësi do të kenë personat që kanë përvojë pune si Roje Pylli;
- Të mos jetë i ndjekur penalisht

Dokumentacioni i nevojshëm;

- Kopja e dokumentacionit të kualifikimit(diploma e shkollës së mesme),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikata e lindjes apo ekstrakti i lindjes,
- Dy rekomandime,
- Dëshmi qe nuk jeni i ndjekur penalisht.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.


Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Afati i aplikimit: Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 01.08.2018 deri më datë : 15.08.2018

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.



Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi